

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

SHOQËRIA

për klasën III

Shkup, 2022

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Shoqëria
Lloji/ kategoria e lëndës mësimore	I detyrueshëm
Klasa	III (e tretë)
Temat	<ul style="list-style-type: none"> • MËSOJ, MARR PJESË, KAM SUKSES • KUJDESEM PËR VETEN DHE RRETHIN TIM • E DUA SHTETI TIM
Numri i orëve	1 orë në javë / 36 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> • Kompjuter, projektor, lidhje interneti; • Foto, ilustrime, revista, gazeta, libra, tekste shkollore etj. për të mbështetur përbajtjet / aktivitetet në lidhje me temat; • Harta gjeografike e RMV; • Lodra për mbështetje të përbajtjeve/aktivitetet (makina, varkë, aeroplan, helikopter, tren, etj.);
Normativi i kuadrit arsimor	<p>Punën edukativo-arsimore në klasën e tretë mund ta kryejë personi që ka të kryer për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • profesor i grupit klasor, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 ECTS • pedagog i diplomuar, VII/1 ose VI/1 (sipas KMK) dhe 240 ECTS

LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e të mësuarit të përcaktuara në programin mësimor çojnë kah përvetësimi i kompetencave të radhës të përfshira me fushën **Shoqëria dhe kultura demokratike** nga standartet kombëtare:

	<i>Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:</i>
VI-A.2	ta analizojë sjelljen e vet në mënyrë që të përmirësohet, duke vendosur qëllime realiste dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet,
VI-A.3	t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, për t'i dëgjuar dhe analizuar pikëpamjet e të tjera e dhe për t'i trajtuar me respekt, edhe kur nuk pajtohet,
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo baze (gjinia dhe përkatësia etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.),
VI-A.6	të njohë praninë e stereotipave dhe paragjykimeve te vetja dhe të tjera e dhe të kundërshtojë diskriminimin,
VI-A.7	të njohin manifestimin e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin e vet, t'i perceptojë pasojat e dhunës dhe ta kundërshtojnë atë,
VI-A.10	për të mbrojtur veten dhe të tjera e në situata krize dhe fatkeqësish natyrore,
VI-A.11	t'i zbatojë rregullat dhe rregulloret për pjesëmarrje të sigurt në trafik,
VI-A.13	të analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, t'i identifikojë rastet e shkeljes së të drejtave dhe të ndërmarrë veprime për respektimin e tyre pa kriter,
VI-A.17	të analizojë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale mbi opinionin publik dhe të zgjedh burime të besueshme të informatave mbi të cilat do ti bazon pikëpamjet e tij.
VI-A.22	t'i identifikojë dhe respektojë të gjitha simbolet kombëtare të shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të shfaqë ndjenjën e përkatësisë ndaj shtetit
	<i>Nxënësi/nxënësja kuption dhe pranon se:</i>
VI-B. 1	nuk guxon të diskriminojë në bazë të dallimeve midis njerëzve (gjinisë dhe përkatësisë etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.),
VI-B. 2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin opinionet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre,

VI-B. 8	çdo qytetar është i detyruar të respektojë ligjet, rregullat dhe rregulloret që rregullojnë sjelljen e njerëzve dhe funksionimin e institucioneve
VI-B. 13	identiteti kombëtar, i cili rrjedh nga përkatësia e shtetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është një komponent i rëndësishëm i identitetit të të gjithë qytetarëve të shtetit.

Programi mësimor, gjithashtu përfshin kompetencat përkatëse në fushat e Standardeve kombëtare:

Shkrim-leximi digital, zhvillim personal dhe social, teknika, teknologji dhe sipërmarrje dhe shprehje artistike dhe kultura.

Nxënësi/nxënësja di dhe është i/e aftë:	
IV-A.2	të vlerësojë kur dhe në çfarë mënyre për të zgjidhur një detyrë/problem është përdorimi i nevojshëm dhe efektiv i TIK,
IV-A.5	të përcaktojë se për çfarë informacioni ka nevojë, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna digitale, informacion dhe përbajtje
IV-A.7	të zgjedhe dhe përdor mjetet e duhura të komunikimit TIK, të ndajë me siguri informacionin, kontaktojë dhe bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në aktivitete shoqërore ose për përdorim personal,
IV-A.8	për të përdorur përbajtjen digitale, rrjetet arsimore dhe sociale dhe retë digitale në një mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme,
V-A.3	t'i identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të vet që ndërtohet në bazë të përkatësisë në grupe të ndryshme sociale (për shembull, gjinisë, identitetit etnik dhe kombëtar) dhe roleve të ndryshme që ai ka në jetë (për shembull, studenti, djali/vajza),
V-A.4	të vlerësojë aftësitë dhe arritjet e tij/saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë përparsitë që do t'i mundësojnë atij/asaj të zhvillohet dhe përparojë,
V-A.5	të njoħe emocionet tek vetja dhe tek të tjerët, të perceptojë pasojat e reagimeve të veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji të përshtatshme për përballimin e emocioneve,
V-A.6	të vendos qëllime për të mësuar dhe zhvillim personal dhe punë për të tejkaluar sfidat që dalin në rrugën drejt arritjes së tyre,
V-A.7	t'i përdor përvojat e veta për të lehtësuar mësimin dhe për të rregulluar sjelljen personale në të ardhmen,
V-A.8	të organizojë kohën e tij/saj në një mënyrë që do t'i mundësojë atij/asaj të arrijë në mënyrë efikase dhe efektive qëllimet e përcaktuara dhe të plotësojë nevojat e tij/saj,

V-A.9	t'i parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe për të tjerët,
V-A.10	të zbatojë parimet etike në vlerësimin e të drejtës dhe të gabuarës në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të shfaqë tipare të virtutshme të karakterit (të tillë si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjojha, vendosmëria, guximi dhe vetë disiplina),
V-A.12	të përballojë me sukses presionet sociale
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të paraqitet në mënyrë të përshtatshme për situatën
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të përgjigjet në mënyrë të përshtatshme, duke treguar empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në mënyrë konstruktive,
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve,
V-A.16	të nlohë problemet në marrëdhëni me të tjerët dhe të afrohet në mënyrë konstruktive në zgjidhjen e konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira,
V-A.17	të kërkojë reagime dhe mbështetje për veten, por gjithashtu të japë informatë kthyese dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve
V-A.19	të japë sugjerime, të marre parasysh mundësitë e ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat në mënyrë që të nxirren përfundime dhe të merren vendime racionale,
V-A.21	të analizojë, vlerësojë dhe përmirësojë të mësuarit e vet,
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe me respekt të vazhdueshëm të rolit dhe kontributit të të gjithë anëtarëve të ekipit,
VIII-A.3	t'i shprehe idetë, përvojat dhe emocionet personale, duke përdorur forma artistike ose forma të tjera të shprehjes krijuuese (individuale ose kolektive),
VIII-A.7	të nlohë dhe shpjegojë sesi pikat kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme,
Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:	
IV-.1	Shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme – e lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim,
IV-B.3	potenciali i TIK do të rritet dhe duhet të monitorohet dhe përdoret, por gjithashtu që duhet të ketë një qëndrim kritik ndaj besueshmërisë, konfidencialitetit dhe ndikimit të të dhënave dhe informacionit të disponueshëm përmes pajisjeve digitale,
V-B.1	kujdesi për trupin e vet dhe praktimi i rregullt i aktiviteteve fizike është kusht i rëndësishëm për sigurimin e shëndetit fizik dhe mendor,
V-B.2	njohja e identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe zhvillimin e personalitetit,
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e dikujt në masë të madhe varen nga puna që investon dhe rezultatet që arrin,
V-B.4	çdo veprim që ndërmerr ka pasoja për të/atë dhe/ose mjedisin e tij/saj,

V-B.5	nga mënyra e qasjes në zgjidhjen e problemeve dhe zgjidhjes së konflikteve varet nga fakti nëse problemet do të janë të zgjidhshme, respektivisht a do të janë konfliktet e zgjidhura,
V-B.7	iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme,
V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu siç ka të drejtë t'i kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij/asaj të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, kështu që ai/ajo ka përgjegjësinë t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat e tyre interesat dhe nevojat,
V-B.9	kërkimi i informacionit kthyes dhe pranimi i kritikës konstruktive shpjinë në përparim personal në nivel individual dhe social,
V-B.10	të mësuarit është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.
VII-B.4	etika e punës, ndjeshmëria kulturore dhe qëndrimi ndaj të tjerëve janë të rëndësishme për krijimin dhe ruajtjen e një klime pozitive pune,
VII-B.5	resurset nuk janë të pakufizuara dhe duhet të përdoren me përgjegjësi

REZULTATET NGA MËSIMI

Tema: **MËSOJ, MARR PJESË, KAM SUKSES**

Numri i përgjithshëm i orëve: **16**

Rezultatet nga mësimi:

Nxënësi/nxënësja të jetë i/e aftë të:

1. të sqarojë se si shteti siguron respektimin e të drejtës për arsimim, cilat janë përfitimet e arsimit dhe si të fitohet një profesion përmes arsimimit;
2. të sqarojë se si duhet mësuar për të arritur sukses në mësim;
3. parashikon pasojat e vepprimeve të tij dhe t'i pranon gabimet në sjelljen e tij ndaj të tjera;
4. përshkruaj si zgjidhen problemet në grup dhe si merren vendimet në grupore.

Nxënësi/nxënësja zhvillon vetëdije:

5. për nevojën për të mësuar gjatë gjithë jetës;
6. se suksesi dhe mossuksesi në mësim varen nga përpjekjet e veta.

Përbajtjet (dhe nocionet):	Standartet e vlerësimit:
<ul style="list-style-type: none">• Kam të drejtë në arsimim (arsimim, shkollë, arsimtar, libër shkollor, fillor, i mesëm dhe arsimi i lartë, shkolla fillore, shkolla e mesme, fakulteti, studenti, profesioni)	<ul style="list-style-type: none">• E identifikon arsimimin si e drejtë e fëmijës dhe shpjegon (përmes një shembulli) se si shteti siguron respektimin e tij.• Shpjegon (përmes shembujve) të paktën dy përfitime të edukimit.• Bën dallimin ndërmjet arsimit fillor, të mesëm dhe të lartë sipas dedikimit dhe moshës së nxënësve/studentëve.• Shpjegon (me shembull) si arsimi të përgatit për një profesion të caktuar.

<ul style="list-style-type: none"> Kam përgjegjësi për të mësuar (vendosja e qëllimit, përkushtimi, fokusi, suksesi, dështimi) 	<ul style="list-style-type: none"> Sqaron nëpërmjet një shembulli se si të vendoset një qëllim në të mësuarit dhe shpjegon pse është e rëndësishme ta bëjmë këtë. Sqaron (përmes shembullit) pse është e rëndësishme të jesh përkushtuar në arritjen e qëllimit mësimor. Përshkruan përmes shembullit se si të sigurohet përqendrimi në të mësuarit dhe sqaron pse është e rëndësishme ta bëjmë këtë. Përmes një shembulli, ai përshkruan si kërkohet ndihmë kur diçka nuk mund të mësohet në mënyrë të pavarur dhe pse është e nevojshme të kërkohet ndihmë. I thekson dhe përshkruan ndjenjat që paraqiten kur përjeton sukses dhe kur përjeton dështim.
---	---

	<ul style="list-style-type: none"> Sqaron (përmes shembullit) se si të mësohet nga mossuksesi i përjetuar.
<ul style="list-style-type: none"> I pranoj gabimet në sjelljen ndaj të tjerëve (sjellja, procedura, pasoja, gabimi qëllimshëm dhe i paqëllimshëm) 	<ul style="list-style-type: none"> Jep një shembull sjelljeje që ka pasoja negative ndaj të tjerëve. Bën dallimin midis gabimit të qëllimshëm dhe të paqëllimshëm në veprimet ndaj të tjerëve. Sqaron (përmes shembujve) se si injoranca dhe pakujdesia mund të çojnë në gabime të paqëllimta në veprimet ndaj të tjerëve. Sqaron pse gabimet në sjelljen ndaj të tjerëve duhet të pranohen në vend që të injorohen ose mohohen.
<ul style="list-style-type: none"> Marr pjesë në marrjen e vendimeve në grup (problemi, zgjidhja e problemit, stuhi idesh, vendim, vendim në grup, shumicë, konsensus) 	<ul style="list-style-type: none"> I përmend rregullat që vlejnë për zgjidhjen e problemeve në grup dhe sqaron pse duhet respektuar ato. Përshkruan (përmes një shembullit) procesin e marrjes së një vendimi në grup nëpërmjet stuhisë së ideve. I përmend dhe sqaron (përmes shembullit) rregullat që vlejnë gjatë marrjes së vendimeve në grup. Të bëjë dallimin ndërmjet një vendimi të marrë me shumicë dhe një vendimi të marrë me konsensus.

Shembuj të aktivitetave:

- Mësuesi shkruan në tabelë fjalinë: “Çdo fëmijë ka të drejtën e arsimimit” dhe sqaron se shteti është i detyruar të garantojnë që kjo e drejtë të respektohet duke kriuar kushte për arsimimin e çdo fëmije. Më pas nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune në të cilën shkruhen fjalët: shkollë, mësues dhe tekstu shkollor dhe nën çdo fjali, brenda grupit, duhet të shkruajnë si lidhet arsimimi me secilën nga tre fjalitë. Pasi secili grup i prezanton përgjigjet për secilën fjali veç e veç, zhvillohet një diskutim se si kontribuon shteti për të pasur shkolla, arsimtarë dhe tekste shkollore. Zakonisht arrihet në përfundim se shkollat i ndërtoton shteti, se mësuesit janë të punësuar nga shteti për të punuar me fëmijët në shkollë dhe i boton tekstet shkollore nga të cilat nxënësit mësojnë.
- Arsimtari i paraqet (njëra pas tjetrës) fjalitë e mëposhtme: (1) Arsimi ju bën më të zgjuar., (2) Njerëzit e arsimuar jetojnë më gjatë dhe kanë shëndet më të mirë., (3) Të arsimuarit fitojnë më shumë. (4) Miqtë krijohen përmes arsimimit. dhe (5) Arsimi i ndihmon njerëzit t'i realizojnë ëndrrat e tyre.
- Pas çdo fjalie, nxënësit, të ndarë në grupe, gjejnë argumente përsë fjalia është e saktë dhe më pas i ndajnë argumentet në një diskutim të hapur që çon në përfundimet e radhës: (1) gjatë arsimimit, njeriu mëson shumë gjëra gjithashtu mëson se si të përdor mendjen për të zgjidhur problemet, (2) arsimi i ndihmon njerëzit të mësojnë se si të kujdesen për shëndetin e tyre, (3) punët me pagesë më të mirë kërkojnë një arsim të lartë, (4) në shkollë dhe jashta shkollës me shokët që shoqëroheni krijoni miqësi (5), ose për të pasur shtëpi më të bukura dhe familje të lumtura, ata duhet të marrin një arsim adekuat.

Arsimtari shkruan në tabelë (njëra poshtë tjetrës) nivelet e arsimit: arsimi fillor, arsimi i mesëm, arsimi i lartë. Më pas fillon një diskutim me të gjithë nxënësit për pyetjet e radhës:

- Në çfarë shkolle mësoni ju?

- Si quhet arsimi që fitohet në këtë lloj shkolle?

- A njihni dikë që mëson në gjimnaz? Si quhet shkolla ku ai ndjek mësimin? Çka është ndryshe nga shkolla fillore?

Si quhet arsimi që merret atje?

- A njihni dikë që studion në fakultet apo dikë që ka mbaruar fakultet? Cili është emri i atij fakulteti? Çfarë do të ndodhë kur të përfundojë/ çfarë bën pasi të përfundojë? Si quhet arsimi që merret atje?

Pasi t'u përgjigjeni pyetjeve për çdo nivel, shkruani përgjigjet në tabelë për emrin e institucionit në të cilin është fituar arsimi i deklaruar. Diskutimi vazhdon me pyetje që kërkojnë të përcaktojnë moshën e nxënësve/studentëve në secilin prej niveleve (dhe përgjigjet përfundimtare shkruani në tabelë):

- Në çfarë moshe fillon dhe mbaron arsimi fillor?

- Në çfarë moshe fillon dhe mbaron arsimi i mesëm?

- Në çfarë moshe filloni të studioni në fakultet?

Diskutimi vazhdon me pyetje rreth dedikimit të çdo niveli arsimor:

- Çfarë lloj njohurish fitohen në arsimin fillor? (Përfundimi i pritshëm: njohuri themelore që ndihmojnë për të vazhduar arsimin)

- Çfarë njohurish fitohen në arsimin e mesëm? (Përfundimi i pritshëm: ose fiton një profesion specifik me të cilin mund të punojë ose merr njohuri që ndihmojnë për të vazhduar në arsimin e lartë)

- Çfarë lloj njohurish fitohen në arsimin e lartë? (Përfundimi i pritshëm: fitohet një profesion i caktuar me të cilin mund të punohet)

• Nxënësit ndahen në grupe. Brenda grupit, secili nxënës thotë se çfarë do të donte të bëhej kur të rritet. Përmes diskutimit në grup, nxënësit theksojnë se çfarë lloj arsimi (të mesëm ose të lartë) duhet të fitojnë në mënyrë që të jenë në gjendje të merren me atë profesion. Më pas secili grup ndan profesionet e tij të dëshiruara dhe arsimtari i shkruan ato në tabelë, pas së cilës të gjithë së bashku

nxjerrin përfundimin se cilat profesione janë të dëshiruara nga më shumë fëmijë. Në fund, secili grup ndan supozimet e tyre për arsimin përmes të cilët fitohen profesionet e përmendura dhe përmes një diskutimi të hapur, me ndihmën e arsimtarit jepen përfundimet se cilat janë përgjigjet e sakta.

• Nxënësit, të ndarë në grupe, nxjerrin një nga kartelat në të cilat përshkruhen dy situata - një situatë tregon një nxënës që ka dështuar në diçka (për shembull, merr rezultat të keq në test, nuk di të zgjidhë të gjitha detyrat e shtëpisë, nuk arrin të shënojë asnjë goditje në orën e edukatës fizike), por nuk shqetësohet fare dhe vazhdon të bëjë diçka që nuk ka lidhje me arsimin (p.sh. luan lojëra në tablet gjatë gjithë ditës, luan futboll në shesh lojërash, shikon filma vizatimorë në televizion) ndërsa në situatën tjetër tregohet një nxënës tjetër që dështoi në të njëjtën gjë, por vendosi një qëllim konkret për t'u përmirësuar (p.sh., për të arritur një rezultat më i mirë në testin tjetër, të mësosh të zgjidhësh të gjitha detyrat e shtëpisë, të mësosh të shënosh të paktën një goditje basketball nga tre gjuajtje). Së pari, secili grup shkruan se çfarë mendojnë se cili nga dy nxënësit do të jetë i suksesshëm në të ardhmen me atë që mësojnë më shumë dhe ofron zgjidhje se si nxënësi i dytë mund të arrijë qëllimin që ka vendosur. Më pas të gjitha grupet i prezantojnë situatat e "tyre" dhe si kanë arritë deri te përgjigjet. Në fund, përmes një diskutimi të hapur, arrihet në përfundimin se vendosja e një qëllimi në mësim ndihmon për të arritur suksesin në atë mënyrë që të përcaktohet se si të arrihet deri te qëllimi dhe të përkushtohet ndaj tij, pavarësisht vështirësive që do të hasen.

• Çdo nxënës merr një fletë pune me të paktën 30 detyra të lehta matematikore (p.sh. $2+3=$ _, $5-2=$ _). Gjatë periudhës 2-minutëshe ndërsa ata janë duke punuar në detyrat, ai u bën atyre një sërë pyetjesh (p.sh., Kush dëshiron të shkojë me pushime në det? Kush dëshiron të ngasë një motor kur të rritet?, Pse fëmijëve nuk u pëlqen të hanë spinaq?) dhe pret përgjigje. Pasi të mbarojë koha, ai i drejton ata të godasin një vijë nën detyrën e fundit të zgjidhur dhe i pyet se sa detyra arriten të zgjidhnin. Pastaj ata vazhdojnë të zgjidhin detyrat, por këtë herë në heshtje.

Pas 2 minutash, i ndalon, u rekomandon të tërhjekin një vijë nën detyrën e fundit të zgjidhur dhe i pyet se sa detyra kanë arritur të zgjidhin

tani. Më pas diskutohet pse herën e parë zgjidhët më pak detyra sesa herën e dytë dhe bashkërisht arrihet në përfundimin se pyetjet që ai

ua dha herën e parë i ka shpërqendruar dhe nuk u ka lejuar të fokusoheshin në detyrat. Së fundi, nxënësit japid shembuj të shpërqendrimeve kur mësojnë në shtëpi (p.sh. telefon, televizor, duke folur me të shtëpisë) dhe së bashku vendosin se si të sigurohen që

të janë të përqëndruar gjatë të mësuarit në mënyrë që të mësojnë më shpejt.

• Arsimtari njofton se do të kërkojë mendimin e tyre se nga kush mundën të kërkojnë ndihmë kur nuk mund të mësojnë vetë diçka. Më

pas ai lexon/paraqet (njëra pas tjetrës) mundësitë e radhës: (1) nga mësuesi/mësuesja, (2) nga një vëlla më i vogël ose motër më e vogël,

(2) nga një prind, (4) nga një shok klase që nuk mund ta mësojë vetë. Pas çdo mundësie të paraqitur, nxënësit ngrenë dorën me gishtin e

madh lart (⌚) nëse janë dakord, pra me gishtin e madh poshtë (⌚⌚) nëse nuk pajtohen me të dhe më pas japid një sqarim pse janë dakord/nuk pajtohen. Në fund, përmes një diskutimi të hapur, konstatohet se nga kush mund të kërkohet ndihmë dhe si ta bëjnë atë.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune me dy grupe rrathësh bosh. Në një grup rrathësh, ata duhet të vizatojnë (nëpërmjet shprehjes së fytyrës) dhe të shkruajnë ndjenjat që lindin kur përfundojnë sukses (p.sh. gëzim, krenari), dhe në grupin e dytë, ndjenjat që lindin kur përfundojnë sukses (p.sh. trishtim, zhgënjim). Më pas secili grup i paraqet dhe i përshkruan ndjenjat e shfaqura të lidhura me suksesin dhe kur të gjitha grupet përfundojnë, prezantohen dhe përshkruhen ndjenjat që lidhen me dështimin. Në fund arsimtari i shkruan në tabelë (në kolona të veçanta) të gjitha ndjenjat për të cilat nxënësit do të bien dakord (në një diskutim të hapur).
- Arsimtari paraqet një situatë në të cilën përshkruhet një nxënës i cili përfundon mossukses edhe pse ka bërë përpjekje për të mësuar (p.sh.: ka bërë një test të keq matematike edhe pse një ditë më parë një orë i ka ushtruar detyrat). Përmes një diskutimi të hapur, analizohet se çfarë kontribuoi për dështimin dhe ofrohen zgjidhje se si nxënësi mund ta përdorë mossuksesin për të arritur sukses. Më pas nxënësit jepin shembuj të ngjashëm nga përvoja e tyre kur përfunduan për herë të parë mossuksesin, pastaj si mësuan nga kjo për ta kthyer mossuksesin në sukses. Në fund, përmes një diskutimi të hapur, bashkërisht arrihet në përfundimin se mossuksesi nuk duhet të na bëjë të dorëzohemi, por përkundrazi na motivon të vazhdojmë të punojmë derisa të arrijmë sukses.
- Nxënësit, të ndarë në grupe, krijojnë dhe përshkruajnë një situatë në të cilën një nxënës bën diçka që ka pasoja negative ndaj nxënësve të tjerë në klasë (p.sh. ai thyen dritaren dhe të gjithë duhet të paguajnë për të, fsheh sfungjerin dhe ata nuk kanë asgjë që ta fshijnë]abelën, harronë të sjell një libër nga i cili duhej të mësonin në klasë, etj.). Më pas secili grup lexon "situatën e tij", a nxënësit e grupeve të tjera zbulojnë se cila është procedura dhe cila është pasoja negative e shkaktuar nga pasoja dhe sqarojnë pse mendojnë se pasoja është negative. Pas çdo situate të lexuar, mësuesi pyet nëse procedura e përshkruar është një gabim i qëllimshëm apo i paqëllimshëm në sjellje dhe kërkon nga nxënësit të sqarojnë pse e konsiderojnë atë të qëllimshme/të paqëllimshme. Pas prezantimeve të të gjitha situatave dhe diskutimeve rreth tyre, zhvillohet një diskutim i hapur për të konkluduar se njerëzit bëjnë gabime në sjelljes që herë janë të qëllimshme e herë të paqëllimshme.
 - Arsimtari u kërkon nxënësve të paraqesin shembuj nga përvoja (personale ose të tjerë) të gabimeve të paqëllimshme në sjelljen ndaj të tjerëve që janë bërë për shkak të: (1) injorancës - pa e ditur se do të kenë pasoja negative dhe (2) pakujdesisë - pa i kushtuar vëmendje ndaj pasojave. Në një diskutim të hapur, arrihet në përfundimin se duhet bërë më shumë kujdes që të mos bëhen gabime që do të kenë pasoja negative për të tjerët.
 - Në njërin skaj të klasës vendoset një fletë me "Nuk jam dakord" dhe në skajin tjetër një fletë me "Jam dakord". Arsimtari shkruan në tabelë fjalinë e radhës: "Çdo sjellje e bërë gabimisht ndaj të tjerëve me pasoja negative duhet të pranohet". Nxënësit vendosen në të dy skajet e klasës në varësi të faktit nëse janë dakord ose jo me fjalinë. Pastaj, më shumë nxënës nga ata që janë dakord dhe ata që nuk pajtohene sqarojnë mendimin e tyre. Në fund, zhvillohet një diskutim i hapur për të konkluduar se kushdo që nuk e pranon se e ka bërë atë (mohimin) ose pretendon se nuk e di pasojën (injoron) po bën një gabim të mëtejshëm që mund të shmanget nëse e

pranon gabimin dhe kërkoni falje për atë që ka bërë.

- Arsimtari u paraqet nxënësve një situatë në të cilën arsimtarja i përfshin të gjithë nxënësit e klasës së saj për të zgjidhur një problem që prek të gjithë ose pjesën më të madhe të klasës (p.sh., shumë shpesh, një pjesë e madhe e plehrave përfundon rreth koshit të plehrave, në vend që të hudhet në të). Pastaj ajo drejton një diskutim mbi pyetjen se përse mësuesja dëshiron që të gjithë nxënësit të marrin pjesë në zgjidhjen e problemit, për të arritur në përfundimi se është një problem që ka të bëjë me të gjithë grupin (p.sh. klasa është një hapësirë që u përket të gjithë nxënësve dhe hapësira e tyre duhet të mbahet e pastër dhe e rregullt). Më pas, nxënësit marin rekomandim që të imagjinojnë se problemi i përshkuar ka të bëjë me klasën e tyre dhe se ata duhet ta zgjidhin atë së bashku. Të ndarë në grupe atyre u jepet një fletë pune me shumë pohime për të cilët duhet përgjigjur E vërtetë/E gabuar, duke pasur parasysh si duan të jetë mënyra e zgjidhjes së problemit.
 - Propozimet për një zgjidhje të mundshme duhet dhënë nga arsimtari. (Përgjigja e pritshme: E gabuar - nxënësit duhet të japid, dhe arsimtari duhet vetëm t'i inkurajojë ata) Të gjithë duhet të dëgjojnë me kujdes çdo propozim. (E saktë - injorimi ose tallja e një propozimi i pengon të gjithë nxënësit të marrin pjesë në dhënien e propozimeve)
 - Asnjë propozim nuk duhet të akuzojë askënd. (E vërtetë – në vend që të zgjidhet problemi, diskutimi do të kthehet në akuza të ndërsjella);
 - Arsimtari duhet të shkruajë në tabelë vetëm sugjerimet e mençura. (E gabuar - të gjitha propozimet shkruhen në tabelë, pavarësisht sa të mençura duken);
 - Duhet zgjedhur propozimi që çon në zgjidhjen e problemit. (E vërtetë - gjatë përzgjedhjes, të gjitha sugjerimet që nuk çojnë në një zgjidhje shpërfillen);
 - Të gjithë nxënësit duhet të marrin pjesë në zbatimin e zgjidhjes. (E vërtetë – pa pjesëmarrjen e të gjithëve, zgjidha nuk do të jetë e përhershme);
 - Të gjithë nxënësit duhet të pajtohen me zgjidhjen e zgjedhur. (E vërtetë - dikush që nuk është dakord me vendimin nuk mund të pritet të marrë pjesë në zbatimin e tij).

Arsimtari pyet, si grupet iu përgjigjën pohimeve (një nga një) dhe pas çdo konstatimi grupet japid një sqarim për përgjigjet e tyre, ndërsa në një diskutim të përbashkët konkludohet në drejtim të përgjigjeve të pritshme të mësipërme. Në fund zhvillohet një diskutim përmes të cilit përcaktohen rregullat e zgjidhjes së përbashkët të problemeve: (1) Të gjithë marrin pjesë në kërkimin e zgjidhjes, (2) Të gjitha propozimet shkruhen në tabelë dhe asnjë propozim nuk kritikohet, dhe (3) Zgjidhja rrjedh nga propozimet e ofruara me të cilat te gjithë dakordohen.

- Arsimtari shkruan në tabelë "Ku dëshironi të shkojmë në shëtitje?" dhe fillon procesin e stuhisë së ideve për të arritur në vendim grupi. Gjatë procesit, ai sigurohet që të respektohen të gjitha rregullat që vlejnë për zgjidhjen e problemeve në grup.
- Procesi zhvillohet në disa faza:

- (1) Të gjithë nxënësit ofrojnë ide që arsimtari i shkruan në tabelë,
- (2) Mësuesi i vendos kriteret për vlerësimin e ideve (p.sh. që mund të arrihet në këmbë, se ka një fushë të rrafshët dhe të gjerë në të cilën do të organizohen lojëra të përbashkëta etj.),
- (3) Idetë e renditura lexohen një nga një dhe zgjidhen ato që plotësojnë kriteret (rekomandohet të nënvízohen në tabelë) dhe
- (4) Zgjidhet një ide ose një kombinim i ideve që plotësojnë kriteret dhe sëbashku me deklarime individuale (duke ngritur gishtin lart-☞ përmarrëveshje, ose poshtë-☞ përmarrëveshje) vendoset se cila ide ose kombinim idesh do të pranohet si vendim përfundimtar. (Nëse vendimi nuk mund të merret me konsensus, ai merret me votim) Pas përfundimit të procesit së diskutimit me

nxënësit, fillon fazë e përmbledhjes së vendimarrjes:

1) Të gjithë nxënësit ofrojnë ide që janë të regjistruar në tabelë, (2) Përcaktohen kriteret për vlerësimin e ideve, (3) veçohen idetë që plotësojnë kriteret dhe (4) nga idetë e nxjerra, përmes deklaratave individuale të nxënësve formohet vendimi i grupit. Më pas mësuesi/ja shkruan në tabelë: "Vendimi me konsensus" dhe "Vendimi me shumicë votash" dhe shpjegon se çfarë do të thotë njëri dhe çfarë do të thotë tjetri dhe shtron pyetjen "Pse është më mirë të merret një vendim me konsensus sesa me shumicë votash të nxënësve?" për të konkluduar se vendimmarrja është më mirë me konsensus sepse të gjithë do ta respektojnë vendimin e marrë në atë mënyrë.

Në fund, nxënësit, të ndarë në grupe, marrin një fletë pune me rregulla të shkruara për marrjen e një vendimi në grup: (1) Të gjithë marrin pjesë në dhënien e ideve, (2) Të gjitha idetë shkruhen në tabelë dhe asnjë nuk kritikohet, dhe (3) Nga idetë e ofruara, nxjerret vendimi i grupit. Sipas secilës prej rregullave të ofruara, shkruani nëse është respektuar kur ata vendosën të shkojnë në një shëtitje dhe jepin një shembull përmes të cilit mund të shihet. Për çdo rregull (një nga një) secili grup paraqet përgjigjet e tij.

Tema: **KUJDESI PËR VETEN DHE MJEDISIN TIM**

Numri i përgjithshëm i orëve: 7

Rezultatet nga mësimi:

